

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6488
E hënë, 13 dhjetor 2021
çmimi 0.40

Prokuroria kërkon
paraburgim për tre të
arrestuarit për sulmin
në Gillogjan | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHQIPËRIA PREKET NGA PËRMBYTJET | FAQE 4-5

KOSOVA E GATSHME TA NDIHMOJË SHQIPËRINË PAS PËRMBYTJEVE



Republika e Kosovës është shprehur e gatshme ta ndihmojë Shqipërinë e cila sërish është prekur nga përmbytjet si pasojë e reshjeve të shumta të shiut. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka treguar se ka telefonuar homologun shqiptar për ta shprehur gatishmërinë e plotë të Kosovës për mbështetje me aftësitë dhe kapacitetet e kërkim-shpëtimit për reagim, menaxhim dhe sanim të pasojave

AKTUALE



NË KËRKIM TË TË MBIJETUARVE,
RRITET NUMRI I TË VDEKURVE
NGA STUHIA NË SHBA | F. 2

VETËM RRETH 300 GRA
ME UNIFORMË TË FSK-së | F. 6

PREMTOHET QË SË SHPEJTI
TË PËRCAKTOHET STATUSI
I ZJARRFIKËSVE | F. 3



EKONOMI



A MUND TA NDALË KOSOVA
RRITJEN E ÇMIMEVE? | F. 7

SPORT



GJILANI DIMËRON
NË POZITËN E PARË | F. 24

Pushimi dimëror në
shkollat e Kosovës
fillon më 31 dhjetor
deri më 10 janar | FAQE 3



META: PËRPJEKJET E
REPUBLIKËS SERBE TË BOSNJË
DHE HERCEGOVINËS RREZIKOJNË
STABILITETIN NË RAJON | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në kërkim të të mbijetuarve, rritet numri i të vdekurve nga stuhia në ShBA

NJU-JORK, 12 DHJETOR - Pasi një tornado e fuqishme preku pjesë të ndryshme të ShBA-së, raportohet për më shumë se 80 të vdekur. Ndërkohë janë duke vazhduar kërkimet për të mbijetuarit në pjesë të gjashtë shteteve amerikane, të prekura nga stuhia. Në lidhje me këtë katastrofë natyrore, presidenti amerikan Joe Biden shpalli gjendje të jashtëzakonshme në Kentaki, shtetin më së rëndi të prekur nga stuhia. Bideni tha se qeveria do të bëjë gjithçka për t'i ndihmuar pjesët qendrore të shtetit në ballafaqim me pasojat e stuhisë. Presidenti amerikan njëkohësisht nënshkroi edhe Deklaratën Federale për Situata të Jashtëzakonshme,

duke mundësuar kështu ndihmë financiare për Kentakin, derisa shtoi se ky tornado ishte ndër më të fuqishmit në historinë e gjithë ShBA-së. Mjete financiare për raste urgjente do të jenë të qasshme edhe për shtetet e tjera të prekura si Misuri, Arkansas, Illinois, Tenesi dhe Misisipi, në rast nevojë. "Bashkë do ta tejkalojmë këtë", deklaroi Biden. Më shumë se 70 persona kanë vdekur më 11 dhjetor vetëm në Kentaki, përfshirë dhjetëra të tjerë të cilët vdiqën në një fabrikë qirinsh, por pritet që numri i viktimave të shkojë mbi 100. Ekipet e ndihmës së shpejtë pa pushim janë duke kërkuar nëpër rrënoja për të mbijetuarit në qytetin

Mejfilld, i cili u prek më së shumti nga tornado. Më shumë se 40 persona u shpëtuan prej rreth 110 sa ndodheshin në fabrikë. Guvernatori i Kentakit, Andy Beshear, tha se nuk do të habitej nëse askush më nuk shpëton nga aty. Në qytetin Mejfilld, ndërkaq, është shkatërruar edhe stacioni i policisë dhe u dëmtuan pajisjet e zjarrfikësve. Dhjetëra mijëra njerëz tashmë kanë mbetur pa rrymë dhe ujë. Persona të vdekur janë raportuar edhe në disa qarqe të tjera, por "numri i të vdekurve në fabrikën e qytetit Mejfilld do të mund ta tejkalonte bilancin e të vdekurve të cilitdo tornado në histori të shtetit", përfundoi guvernatori.



Në lidhje me numrin e të vdekurve në ShBA reagoi edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Nëpërmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", Kurti ngushëlloi familjarët dhe miqtë e të vdekurve. "Lajm tronditës

nga ShBA-ja. Ngushëllimet tona për familjen dhe miqtë e mbi 100 jetëve të humbura në tornadot e Kentakit dhe falënderimet më të sinqerta për reaguesit e parë që e vunë veten në rrezik", ka shkruar Kurti.

Scholz kërkon përkushtim në betejën me pandeminë



BLERIN, 12 DHJETOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka bërë thirrje për fleksibilitet për marrjen e masave kundër Covid-19. Ai ka thënë të dielën se në luftën kundër pandemisë së koronavirusit nuk do të ketë vija të kuqe. "Duhet vepruar shpejt dhe me vendosmëri. Kjo pandemi na tregoi këtë. Duhet të jemi

gjithmonë të gatshëm të rimendojmë nëse rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë", ka pohuar ai për gazetën gjermane "Bild". Scholz ka njoftuar se janë krijuar kushtet që në spitalet gjermane të ketë shtretër të kujdesit intensiv, pavarësisht nëse do të ketë numër të madh të pacientëve me

Covid-19. Ai njoftoi, po ashtu, se janë duke menduar ndalimin e fishekzjarrëve në natën e Vitit të Ri, në mënyrë që të parandalohet fluksi i madh i njerëzve që mund të kërkojnë ndihmë në urgjencë. Scholz u bëri thirrje qytetarëve që ende nuk janë vaksinuar, t'i marrin dozat e vaksinës kundër Covid-19.

Bennett, kryeministri i parë izraelit që viziton EBA-në



JERUSALEM, 12 DHJETOR - Naftali Bennett është kryeministri i parë izraelit i cili udhëton në Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA) për vizitë zyrtare. "Kryeministri Naftali Bennett do të udhëtojë në vizitën e parë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe me ftesë të princit të kurorës së Abu Dabit,

Mohammed bin Zayed", ka njoftuar zyra e kryeministrit izraelit më 12 dhjetor. Të hënën Bennett pritet të takohet me princin e Abu Dabit, Mohammed, ndryshe, de facto, sundimtar i shtetit. Bisedimet në mes të dy zyrtarëve pritet të përqendrohen në raportet mes

dy vendeve, por do të flitet edhe për tema të tjera që ndërlihen me ekonominë apo rajonin. Shtatorin e vitit të shkuar Izraeli nënshkroi një mori marrëveshesh me EBA-në dhe Bahrejnin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Në verë, EBA hapi ambasadën

në Tel Aviv. Shtetet vendosen edhe fluturime të drejtpërdrejta derisa ekonomia konsiderohet pika e përbashkët për afrimin e raporteve. Megjithatë, Izraeli, njëjtë sikurse Emiratet e Bashkuara Arabe, krijuan aleancë edhe për ballafaqim me Iranin.

Basha: Berisha nuk ka shans t'i kërcënojë demokratët në shtëpinë e tyre

TIRANË, 12 DHJETOR - Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka dalë me një mesazh të dielën para se të nisë mbledhja e Këshillit Kombëtar të kësaj partie. Ai ka

thënë se Sali Berisha nuk ka shans t'i kërcënojë demokratët në shtëpinë e tyre. "Askush, përfshirë Sali Berishën, nuk do të ketë shansin t'i kërcënojë

demokratët në shtëpinë e tyre. PD-ja që u themelua si shtëpia e lirisë, nuk do të shndërrohet në bunker për askënd, as sot as kurrë", ka thënë Basha në

mesazhin e tij. Të shtunën Sali Berisha ka mbledhur kuvendin e PD-së, anëtarët e të cilit kanë shkarkuar Lulzim Bashën nga pozita e kryetarit të PD-së.



Pushimi dimëror në shkollat e Kosovës fillon më 31 dhjetor deri më 10 janar

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Pushimi dimëror për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës do të nisë në fund të këtij muaji. Sipas zëdhënëses së MASHTI-t, Iliriana Pylla, procesi mësimor do të përfundojë më 30 dhjetor dhe pushimi do të nisë nga data 31 dhjetor. "Sipas vendimit të fundit të

MASHTI-t, procesi mësimor do të përfundojë më 30 dhjetor, dhe pushimi dimëror do të zgjasë deri më 10 janar në rast se nuk ndryshon ky vendim gjatë ditëve të ardhshme", ka thënë Pylla.

Viti shkollor kishte nisur me një muaj vonesë për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. MASHTI, në

konsultim me të gjithë aktorët e tjerë të arsimit, kishin marrë vendim për kompensimin e ditëve të humbura për vitin shkollor 2021-2022. Kompensimi i ditëve të humbura është vendosur të mbahet të shtunave, dhe ka nisur që nga data 9 tetor 2021, kur edhe do të përfundojë më 24 qershor 2022.



Meta: Përppjekjet e Republikës Serbe të Bosnjë dhe Hercegovinës rrezikojnë stabilitetin në rajon



EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 12 DHJETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar lidhur me situatën e krijuar për përshkallëzimin e përpjekjeve të Republikës Serbe të Bosnje dhe Hercegovinës për të krijuar struktura paralele. Ai ka shkruar në "Facebook" se një iniciativë e tillë për ta filluar punën për krijimin e këtyre institucioneve dhe hartimin e një kushtetute të re, shkojnë në drejtimin e kundërt të përpjekjeve 26-vjeçare të qytetarëve boshnjakë. Meta thotë se kështu rrezikohet seriozisht stabiliteti rajonal dhe vështirësohet jetesa e qytetarëve

të të gjitha nacionaliteteve, si dhe dëmtohet rëndë shteti ligjor dhe perspektiva e integritetit evropian të vendit dhe rajonit. "Shpreh shqetësimin e thellë për përshkallëzimin e përpjekjeve të Republikës Serbe të Bosnjë dhe Hercegovinës për t'u tërhequr nga institucionet shtetërore dhe për t'i krijuar institucionet paralele të ushtrisë, gjykatave dhe sistemit tatimor. Iniciativa e ligjvënësve të Parlamentit të Republikës Serbe për ta filluar punën për krijimin e këtyre institucioneve dhe hartimin e një kushtetute të re, shkojnë në drejtimin e kundërt të përpjekjeve 26-vjeçare të qytetarëve boshnjakë, liderëve

lokalë dhe bashkësisë ndërkombëtare për ta forcuar paqen dhe sigurinë në Bosnjë dhe Hercegovinë", ka thënë Meta.

Ai ka bërë thirrje për angazhimin në dialog të politikanëve të Republikës Serbe dhe të Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre me mirëbesim reciprok, me qëllim të avancimit të reformave të nevojshme për përmirësimin e jetës së qytetarëve, avancimin e proceseve integruese të shtetit të tyre, çka do t'i shërbente edhe forcimit të paqes dhe sigurisë në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Premtohet që së shpejti të përcaktohet statusi i zjarrfikësve

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Zjarrfikësit po vazhdojnë ta kërkojnë zgjidhjen e statusit të tyre, por që kjo kërkesë e tyre tashmë e sa vite nuk po merr epilog. Zjarrfikësit aktualisht pagat i marrin nga komunat, ndërsa menaxhohen nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Megjithatë, institucionet shtetërore premtojnë se kjo çështje do të zgjidhet së shpejti. Mospërcaktimi i kompetencave menaxhuese në mes të pushtetit lokal dhe pushtetit qendror po

vlerësohet si arsye pse shërbimi i zjarrfikësve ka mbetur në një gjendje të keqe, pa investime e me buxhet të ulët.

Kryetari i Shoqatës së Zjarrfikësve të Kosovës, Muharrem Beka, thotë se zjarrfikësit kanë mbetur në gjendje të mjerueshme, me buxhet të vogël e me pajisje të punës tejet të vjetërsuara. Arsyë për këtë gjendje thotë se është mungesa e përcaktimit të statusit, pasi që shprehet se komunat dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk po ofrojnë zgjidhje për problemet e tyre, por vetëm po e hedhin fajin

te njëra-tjetra. Përveç përcaktimit të statusit, Beka thotë se zjarrfikësit kërkojnë edhe kompensimin e ndërrimit të natës për festat dhe për punën jashtë orarit.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Enver Dugolli, që është edhe pjesë e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, thotë se çështja e statusit të zjarrfikësve do të trajtohet me prioritet edhe në kuadër të komisionit.

Kritike për qeverinë për moszgjidhjen e statusit të zjarrfikësve janë partitë opozitare, pjesë e Komisionit për



Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Kryetari i këtij komisioni, Bekë Berisha, deklaroi se është tejet e rëndësishme që të përcaktohet

statusi i zjarrfikësve, derisa thotë se është shumë më mirë që zjarrfikësit të merren nën menaxhim nga niveli qendror. (ksp)

36 pacientë me Covid po marrin trajtim mjekësor

Prishtinë, 12 dhjetor - Shërbimi Klinik Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar që në QKUK dhe në spitalet e

tjera të përgjithshme në Kosovë janë duke u trajtuar 36 pacientë, 6 prej tyre pozitivë me Covid-19, kurse 30 të tjerë post-

Covid. "Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, bazuar në raportet e datës 12 dhjetor 2021, në trajtim

mjekësor janë 36 pacientë, 6 prej tyre me Covid-19 pozitivë dhe 30 të tjerë post-Covid. Me oksigjenoterapi janë 5 pacientë,

kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka pacientë të shtrirë", thuhet në raportin e ShSKUK-së.



SHQIPËRIA PREKET NGA PËRMBYTJET

Kosova e gatshme ta ndihmojë Shqipërinë pas përmbytjeve

Republika e Kosovës është shprehur e gatshme ta ndihmojë Shqipërinë e cila sërish është prekur nga përmbytjet si pasojë e reshjeve të shumta të shiut. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka treguar se ka telefonuar homologun e tij shqiptar për ta shprehur gatishmërinë e plotë të Kosovës për mbështetje me aftësitë dhe kapacitetet e kërkim-shpëtimit për reagim, menaxhim dhe sanim të pasojave

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Reshjet e shumta të shiut në 24 orët e fundit kanë bërë që disa rajone të Shqipërisë të preken nga vërshimet. Shqetësimin më të madh e ka sjellë situata e krijuar për shkak të daljes nga shtrati të lumit Vjosa në urën e Mifolit, i cili ka shkaktuar përmbytjen e disa fshatrave. Pas kësaj gjendjeje kanë reaguar institucionet e Kosovës, duke shprehur gatishmërinë për t'u dalë në ndihmë institucioneve të Shqipërisë për ta përballuar këtë situatë.

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka bërë me dije se është duke e ndjekur me

seriozitet situatën e krijuar si pasojë e reshjeve me intensitet të lartë të rëna ditët e fundit.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, ka dalë në terren dhe, pas vëzhgimit, ka thënë se situata është emergjente në zona të caktuara në veri dhe jug të vendit. Ai ka treguar se dëmet për shkak edhe të investimeve të kryera vitet e fundit janë më të vogla krahasuar me vitin 2017. "Dëmi është shumë më i vogël se në vitin 2017, për shkak edhe të ndërhyrjes që kemi bërë në këto vite, ku kemi krijuar një argjinaturë. Kjo ndërhyrje ka bërë që lumi të mos dalë nga Darëzeza, duke mbrojtur shumë toka nga përmbytjet. Kemi bërë disa

evakuime, kemi vepruar me kohë, kemi pasur bashkëpunim edhe me banorët. I kuptoj emocionet e banorëve në këto situata, por ne kemi 10 ditë që njoftojmë për parashikimin. Prej 10 ditësh kemi ngritur shtabet e emergjencave", ka thënë Peleshi. Sipas tij, rritja e nivelit të ujit tek Ura e Mifolit është më e madhja e parë ndonjëherë. "Nga veriu në jug kemi situata emergjente, në jug është më masive për shkak të përmbytjes, por edhe në veri, si në Theth, kemi një bllokim rrugësh apo akse, ku kalohet me vështirësi, e disa fshatra po përjetojnë mungesën e energjisë elektrike", ka shtuar ai. Sipas tij, në qarkun e Gjirokastrës të gjithë rrugët kombëtare janë lehtësisht të kalueshme. Ai ka treguar se në përgjithësi të gjitha tokat e përmbytura kanë kulluar dhe niveli i ujit në shtratin e lumit Drino ka një ulje prej 30 cm dhe ndodhet brenda shtratit të tij. Ministri i Mbrojtjes, bazuar edhe në parashikimet e motit nga IGJEUM, ka thënë se

pritet që në orët në vijim të ketë përmirësim të reshjeve. Ndaj situatës së përmbytjeve në Shqipëri ka reaguar edhe Ministria e Mbrojtjes e Kosovës, ministri Armend Mehaj, i cili ka njoftuar se ka telefonuar ministrin e Mbrojtjes së Shqipërisë, Niko Peleshi. Ai ka shprehur gatishmërinë e institucioneve të Kosovës për ta ndihmuar Shqipërinë. "Në ditë të mira e ditë të vështira jemi bashkë me vëllezërit tanë në Shqipëri. Pas përmbytjeve në zonën e Fierit dhe në zona të tjera të Shqipërisë, i kam telefonuar ministrin të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Niko Peleshi, të cilit i kam shprehur gatishmërinë tonë të plotë për mbështetje me aftësitë dhe kapacitetet tona të kërkim-shpëtimit për reagim, menaxhim dhe sanim të pasojave. Së bashku jemi më të fortë në secilën sfidë!", ka shkruar Mehaj në profilin e vet në "Facebook".

Pas situatës së rënduar të krijuar nga moti i lig, veçanërisht në jug të vendit,

në Fier dhe Vlorë, ka reaguar presidenti Ilir Meta. Meta thotë se problematik është fakti që ashtu si në të kaluarën, autoritetet e mbrojtjes civile dhe prefekturat nuk e kanë njoftuar më herët popullatën në zonat me risk të lartë. "Duke u solidarizuar me banorët e prekur nga pasojat e motit të keq, u bëj thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse shtetërore të angazhohen maksimalisht për sigurinë e jetës dhe të pronës", është shprehur ai.

Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka treguar se institucionet shqiptare kanë marrë të gjitha masat për t'u dalë në ndihmë zonave të prekura nga përmbytjet. "Në terren me të gjitha kapacitetet dhe pa ndërprerje, në zonën e prekur nga dalja e Vjosës prej shtratit të saj, si pasojë e reshjeve intensive. Informon Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, nga pika kritike e Urës së Mifolit", ka shkruar Rama në profilin e vet në "Facebook".

Prokuroria kërkon paraburgim për tre të arrestuarit për sulmin në Glogjan

PEJË, 12 DHJETOR - Prokuroria Themelore në Pejë ka kërkuar masën e paraburgimit për tre personat e arrestuar si të dyshuar për sulmin në fshatin Glogjan të Deçanit më 26 nëntor. Zëdhënësi i kësaj prokurorie, Shkodran Nikçi, ka thënë tre të arrestuarit dyshohen se kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë dhe armëmbajtje pa leje. "Prokurorja e rastit ka parashtruar kërkesën për masën e paraburgimit. Këtë kërkesë e ka elaboruar sot në

seancën e procedurës paraprake para gjyqtarit. Shpresojmë që gjyqtari ta marrë vendimin e duhur", ka thënë Nikçi.

Të shtunën, më 11 dhjetor, Policia e Kosovës arrestoi tre persona si të dyshuar për vrasjen e trefishtë që ndodhi më 26 nëntor në fshatin Glogjan të Deçanit.

Pas sulmit që iu bë një autobusi, i cili udhëtonte nga Gjakova drejt Glogjanit, u vranë ngasësi i autobusit dhe dy nxënës që ndodheshin brenda.



Berisha: Qeveria ka marrë peng udhëheqjen e PD-së

TIRANË, 12 DHJETOR - Në "Foltoren" e radhës me shqiptarët në Florida të ShBA-së, ish-kryeministri Sali Berisha e ka cilësuar të jashtëzakonshëm Kuvendin Kombëtar që u mbajt dje, thirrur nga firmat e delegatëve.

Lideri historik i demokratëve, ndër të tjera, tha se Partia Demokratike është marrë peng nga qeveria e Edi Ramës. Berisha tha se duhet t'i "pranojmë edhe presionet e pandershme ndaj Lulzim Bashës", sipas tij, i asistuar edhe nga ambasadorja amerikane në Tiranë, Yuri



Kim. "Ishte më i jashtëzakonshmi, ndoshta edhe në historinë e pluralizmit të vendeve të tjera, sepse ky ishte vendi i

parë që mblidhej me firmat e anëtarëve, pasi udhëheqja e kësaj partie nuk pranonte ta mblidhte Kuvendin sepse e dinte që do t'ua tregonte

atyre vendin e merituar për shkëmbimin e statutit të PD-së. Për shkëmbimin që u kishin bërë forumeve, parimeve, për vendosjen e kësaj force nga forcë konservatore në një parti të majtë tërësisht e larguar nga vlerat tona të përbashkëta, liritë dhe të drejtat njerëzore. Besimet, vlerat e familjes, e larguan nga interesi kombëtar dhe dinjiteti njerëzor. Për të gjitha këtu, pas një konsulte dymujore me atë që e quajmë foltore, ku u mblodhën dhjetëra mijëra demokratë kundër presioneve të qeverisë që ka marrë peng. Duhet t'i

pranojmë edhe presionet e pandershme edhe të pengut të qeverisë, ish-kryetarit Basha, i asistuar në një mënyrë ose tjetër edhe nga ambasadorja Yuri Kim, që me ndërhyrjet e saj është kataliste e gjendjes së krijuar, faktikisht e marrjes peng të opozitës nga qeveria. Ju e dini që një vendim me datë 19 maj u shpall nga DASH, në të cilin njoftohesha se jam shpallur 'non grata' për korrupsion. Në letrën që i drejtoj sekretarit Blinken u them se ky është një akt i lotimit korrupsion të Ramës dhe George Soros", ka deklaruar Berisha.

Quni jep dorëheqje nga posti i kryetarit të LDK-së në Prizren

PRIZREN, 12 DHJETOR - Anton Quni ka dhënë dorëheqje nga detyra e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Dega në Prizren. Quni ka thënë se dorëheqje po jep pasi nuk ka marrë rezultatet e duhura në zgjedhjet lokale. "Të dashur qytetarë, unë sot kam dhënë dorëheqje nga detyra e kryetarit të LDK-së, Dega në Prizren. Këtë vendim e mora si përgjegjësi morale e imja për mosarritjen e rezultatit të duhur në zgjedhjet lokale. Pavarësisht prej ngritjes së numrit të votave, në krahasim me zgjedhjet nacionale 2021, dhe rritjes së numrit të kuvendarëve, ishte e pamjaftueshme që të jemi

në raundin e dytë për të parin e komunës", ka pohuar Quni.

Mes të tjerash, ai ka njoftuar se autorizimet e tij i ka bartur te Hatim Baxhaku. "Nga sot, me pajtimin e Kryesisë së Degës, autorizimet e mia i kam bartur te nënkryetari dr. Hatim Baxhaku i cili në ditët në vijim do t'i bashkëkoordinojë veprimet e aktivitetet me kryetarin e LDK-së, z. Lumir Abdixhiku. Unë vazhdoj të mbetem dhe të angazhohem si anëtar i Kryesisë së Degës, nënkryetar i LDK-së në qendër dhe deputet i GP të LDK-së", thotë ai.

Më tutje, ai ka pohuar se për



të ka qenë privilegj të ishte kryetar i degës. "Të qenit kryetar i degës ishte privilegj

dhe përvojë e mirë, por jam i bindur se me dorëheqjen time po mundësohet një

riorganizim më i mirë i LDK-së në Prizren, nëndegëve dhe forumeve, me të cilin do të krijohen parakushtet për afirmimin e të rinjve të Prizrenit, për ruajtjen e bërthamës dhe hapjen e derve për më shumë njerëz e kuadro që do ta forcojnë LDK-në dhe do ta bëjnë konkurrenca serioze për ciklin e ri zgjedhor. Faleminderit të gjithë votuesve dhe bashkëpunëtorëve që në çdo situatë më qëndruan afër! U jam mirënjohës dhe vazhdojmë punët e mira për vendin e për LDK-në", ka shkruar Quni në llogarinë e vet në "Facebook".

Vetëm rreth 300 gra me uniformë të FSK-së

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Në Kazermën "Minatori" të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Mitrovicë, prej 400 ushtarëve sa janë gjithsej, 37 prej tyre janë gra. Në mesin e tyre është edhe 22-vjeçarja nga Skenderaj, Lirijona Bajraktari. Ajo e veshi uniformën në vitin 2019, kur edhe filloi transformimi i misionit të FSK-së nga civil në ushtarak. "Mbajtja e armës është një përgjegjësi e madhe dhe, pavarësisht që jam e re në FSK, [kjo] është bërë një pjesë e jona dhe e aktiviteteve tona ditore që i kemi. Sigurisht që është ngarkesë për shkak se shumë shpesh kemi trajnime që kërkojnë përgatitje të lartë, qoftë fizike, qoftë psikike, taktike... Edhe kemi marshime me pesha të rënda, kemi javë të tëra në terren", rrëfen ajo. Lirijona lindi më 1999, në vitin kur përfundoi lufta e fundit në

Kosovë. Thotë se rrëfimet e prindërve për këtë pjesë të historisë e frymëzuan që një ditë të betohet se do të shërbejë për popullin dhe Republikën e Kosovës. "Si inspirim për t'u bërë ushtarë ka qenë historia të cilën e kemi kaluar. Në një mënyrë apo tjetër, çdonjëri nga ne është prekur nga historia e fundit. Kështu që kam menduar se ndoshta mënyra më e mirë për t'i shërbyer vendit është duke qenë pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës", thotë ajo. Lirijona thotë se ka shumë paragjykimë nëse gratë janë të afta për të qenë pjesëtare të ushtrisë. "Mendoj se FSK-ja ka dhënë shumë shembuj të pjesëtareve të saj që i kanë sfiduar këto paragjykimë. Kam qenë shumë me fat që kam pasur përkrahjen dhe mbështetjen maksimale nga familja ime", thotë ajo.

Përpjekjet për ta rritur përqindjen e grave në FSK

Prej 2 500 sa është numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të FSK-së, rreth 300 apo 11 për qind janë gra, me grada kolonel, nënkolonel, major e të tjera. Shefi i Komunikimit Strategjik në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Sefer Isufi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kushtet për pranim në FSK nuk lidhen me gjininë, ndonëse thekson se janë bërë disa fushata për ta rritur interesimin dhe aplikimin e grave. "Koncepti i ndërtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është vetëm në bazë të performancës, shkathtësive dhe aftësive profesionale që demonstroi një pjesëtar i FSK-

së, pa dallim a është burrë apo grua, pa dallim a është djalë apo vajzë", thotë Isufi. Komuna e Dragashit nuk ka asnjë grua me uniformë të FSK-së.

Brikena Avdyli nga "Fondacioni Jahjaga", që promovon mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, tregon se në tetor të këtij viti kanë organizuar një aktivitet me vajzat e Dragashit. "Vajzat kanë mundur të shohin që ato mund të kyçen në këto profesione, jo detyrimisht ta sakrifikojnë jetën e tyre individuale. Policet dhe gratë në FSK kanë treguar se ato i kryejnë të gjitha punët e tyre dhe vazhdojnë të kthehen në shtëpi dhe të kujdesen për fëmijët, për familjen. Në fund [të aktivitetit], ne e bëmë pyetjen se a do të kishin pasur interesim vajzat në sallë ta konsiderojnë një profesion të tillë. Goxha disa duar u ngritën", thotë Avdyli.

Shpat Balaj, nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Ministria e Mbrojtjes duhet të

punojë më shumë për ta rritur numrin e grave në FSK, e sidomos në pozita udhëheqëse.

Aktualisht grada më e lartë që mban një grua në FSK është gjeneralbrigade. "Në përgjithësi, kjo sfera e mbrojtjes në Kosovë shihet si diçka që është ekskluzive për burra, e që realisht nuk është ashtu në praktikë. Prandaj, është shumë e nevojshme që përmes edukimit, edhe përmes përfshirjes sa më të gjerë të grave të thuhet kjo, ky perceptim, dhe të bëhen hapa përpara drejt përmirësimit të statistikave në përgjithësi, gjithashtu edhe të përfaqësimit në nivel strategjik të grave", thotë Balaj. Nga vendet e rajonit, në Serbi 20 për qind e pjesëtarëve të ushtrisë janë gra; në Shqipëri 18 për qind; në Mal të Zi 14 për qind. Vetëm në Maqedoni të Veriut përqindja është më e vogël se në Kosovë, saktë 9 për qind.

Një përqindje më të lartë të grave Kosova e ka në policinë e saj. Prej 9 100 pjesëtarëve të policisë, 15 për qind janë gra.



Rregullohet problemi, rifillon vaksinimi në Prishtinë



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Për disa orë procesi i vaksinimit në qendrën e vaksinimit për Covid-19 në sallën "1 Tetori" në Prishtinë ishte ndërprerë për shkak të disa problemeve. Menaxheri i kësaj qendre, Niman Bardhi, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se nga ora 10:00 deri në orën 14:00 të dielën qytetarët nuk kanë mundur të vaksinohen. "Vaksinimi ka vazhduar sipas planit. Sistemi tani është në funksion dhe procesi i vaksinimit është duke vazhduar

pa asnjë problem", ka thënë Bardhi. Ai ka thënë se "procesi i vaksinimit është duke vazhduar duke bërë regjistrimin e qytetarëve në librat e protokollit, më pas do të futen të dhënat në sistem sapo të funksionalizohet". Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në Kosovë janë regjistruar shtatë raste të reja me koronavirus. Sipas të dhënave të IKShPK-së, këto raste kanë rezultuar pas testimit

të 1 011 mostrave. Po sipas raportit të këtij instituti, në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 10 pacientë. Aktualisht në Kosovë janë 321 raste aktive me koronavirus.

Sa i përket vaksinimit, brenda 24 orëve janë dhënë 965 vaksina kundër koronavirusit. Që nga fillimi i fushatës së vaksinimit në Kosovë, në mars të këtij viti, në gjithë vendin janë dhënë 1 644 35 doza të vaksinës.

Deri të dielën, më 12 dhjetor, të dyja dozat e vaksinës i kanë marrë 772 388 qytetarë.

A mund ta ndalë Kosova rritjen e çmimeve?

Prishtinë, 12 dhjetor - Qeveria e Kosovës e gjen veten përballë kërkesave të qytetarëve për të vepruar kundrejt rritjes së çmimeve të prodhimeve bazë. "Mendoj se duhen rritur rrogat dhe të barazohemi me çmimet që janë rritur", thotë Blerina Qerimi, qytetare e Prishtinës. "Kushtet e popullatës sonë janë të tilla që nuk ka mundësi t'i përballojë këto çmime. Shteti duhet ta ndalojë shtrenjtimin e miellit, bukës dhe të gjërave të tjera elementare", ka thënë Sali Ejupi, po ashtu nga kryeqyteti. Agjencia e Statistikave e Kosovës në raportin e publikuar më 7 dhjetor ka bërë me dije se çmimet e prodhimeve të konsumit janë rritur për 5.7 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2021. Rritja më e lartë është vërejtur te buka, drithërat, mishit, qumështi, djathi, vaji, vezët, pemët dhe perimet.

Rritje ka pësuar edhe çmimi i energjisë elektrike.

Situatë e ngjashme me çmime është edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe në Evropë. Deri te kjo ka ardhur për shkak të pengesave në zinxhirin e furnizimeve që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit si dhe për shkak të rritjes së çmimeve të gazit.

Për ta lehtësuar bazën ekonomike mbi qytetarët, vende si Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë ngrirë çmimet e prodhimeve bazë.

Qeveria e Kosovës thotë se është duke bërë veprime të tjera që, sipas saj, do t'i përgjigjen në mënyrë të ligjshme dhe të

përshtatshme situatës së krijuar. "Jemi duke punuar për funksionalizimin e plotë të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nëpërmjet plotësimit të bordit", thotë zëdhënësi Përparim Kryeziu.

Ai ka theksuar se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë tashmë ka proceduar për miratim Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës i cili parasheh fushat dhe format e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për konkurrencë të shëndoshë të tregut.

Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Një formë për ndërhyrje: Rritja e pagave

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, thotë se vendimi potencial i Qeverisë për ngrirje apo ndërhyrje në çmimet e tregut do të binte ndesh me Kushtetutën e Kosovës. "Nuk e di nëse ngrirja e çmimeve është mënyra më e mirë. Nuk e kam parë këtë praktikë në nivel evropian. Duhet shikuar formë tjetër, jo këtë formë", thotë Rukiqi për "Radion Evropa e Lirë".

Si formë tjetër ai përmend rritjen e pagave.

Paga mesatare bruto në Kosovë llogaritet të jetë rreth 460 euro. Paga mesatare bruto në sektorin publik është rreth 620 euro, ndërsa në sektorin privat rreth



380 euro.

Rukiqi thotë se në Kosovë, qysh në vitin 1999, nuk ka pasur inflacion më të lartë se këtë vit. "Ngritja e çmimeve ka ndikuar shumë në mirëqenien e qytetarëve. Qeveria duhet ta zbusë këtë barrë që ka popullata", thotë ai.

Sipas profesorit të ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, Qeveria e Kosovës duhet të nisë subvencionimin e prodhuesve ose të ndërhyjë në planin e politikave sociale për ta zbutuar situatën që ka krijuar rritja e çmimeve.

Në tetor, Qeveria e Kosovës ka ndarë disa mjete nga Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike për mbështetjen e përfituesve nga

skemat sociale dhe pensionale. Përfituesit e skemave pensionale në muajin nëntor kanë marrë nga 100 euro shtesë mbi pensionin e rregullt, ndërsa përfituesit e skemave sociale në muajin nëntor dhe dhjetor marrin dyfishin e pagesës së rregullt.

Si kanë ndërhyrë Maqedonia e Veriut dhe Serbia në kontrollimin e çmimeve?

Maqedonia e Veriut, e cila ka ngrirë çmimet e prodhimeve bazë, në periudhën janar-shtator të këtij viti ka pasur ngritje të koston së jetesës për 2.8 për qind.

Qeveria maqedonase ka vendosur që t'i ngrijë çmimet e produkteve bazë - bukës, sheqerit, miellit, vajit, qumështit, mishit, djathit dhe gjizës në nivelin e 1 dhjetorit.

Ngrirja do të vlejë deri më 31 janar të vitit të ardhshëm dhe kjo nënkupton që tregtarët, brenda kësaj periudhe, nuk mund t'i prekin çmimet.

Ngjashëm si Maqedonia e Veriut ka vepruar edhe Serbia.

Qeveria atje ka marrë vendim më 30 nëntor që t'i ngrijë çmimet në nivelin e 15 nëntorit për 60 ditë. Ngrirja vlen mbi çmimet e sheqerit, miellit, vajit, mishit të derit dhe qumështit. Inflacioni në Serbi në muajin shtator ka qenë 4.3 për qind.

Sindikalistët akuzojnë qeverinë se po bllokton ngritjen e pagës minimale

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Këshilli Ekonomik-Social që, mes të tjerash, ka përgjegjësi edhe përcaktimin e pagës minimale, nuk është funksionalizuar në mungesë të përfaqësuesve nga qeveria. Kjo nga sindikalistët po shihet si e qëllimshme, derisa ekzekutivi thotë se shumë shpejt do t'i dërgojë emrat.

Të shpeshta kanë qenë kritikantë e LV-së për qeveritë e kaluara në lidhje me mosngritjen e pagës minimale, por që nga ardhja në pushtet ende nuk ka pasur ndonjë lëvizje në këtë drejtim. Madje as Këshilli Ekonomiko-Social që, mes të tjerash, ka përgjegjësi edhe përcaktimin e pagës minimale, nuk është funksionalizuar për arsye që lidhen me qeverinë.

Kryetari i Këshillit Ekonomiko-Social, Atdhe Hykoll, thotë se qeveria nuk ka dërguar emrat për t'i plotësuar vendet e zbrazëta, duke pamundësuar

funksionalizimin e këshillit. "Këshilli Ekonomik-Social para dy jave është konstituuar. Ne po presim që Qeveria e Kosovës sa më shpejt t'i dërgojë anëtarët që i takojnë në këtë këshill dhe pastaj të flasim edhe për pagën minimale. Paga minimale duhet të negociohet çdo fundvit në mënyrë që vitin tjetër të jetë e gatshme", ka deklaruar Hykoll për "RTV Dukagjinin".

Jusuf Azemi nga Sindikata e Sektorit Privat dyshon se qeveria qëllimisht po i vonon emrat e anëtarëve të saj në këshill. "Mendoj se mungesa e anëtarëve të qeverisë është e qëllimshme për t'i ikur ngritjes së pagës minimale. Kryeministri dhe bashkëpunëtorët e tij e dinë se shefi i ekzekutivit duhet të nënshkruajë në fund pagën minimale", ka deklaruar Azemi.

Megjithatë, nga qeveria kanë thënë se emrat do të dorëzohen së shpejti. "Ne jemi duke bërë



përgatitjet e duhura dhe së shpejti do t'i dorëzojmë emrat e përfaqësuesve tanë", thuhet në

përgjigjen e qeverisë. Aktualisht paga minimale në Kosovë është 170 euro për të

punësuarit mbi moshën 35-vjeçare, ndërsa 130 euro për ata nën moshën 35-vjeçare.



TREGIM NGA BRUNO SCHULZ

‘Arratia e fundit e tim eti’

Kjo ka bërë vaki në një periudhë të vonë e të përhumbur rënieje të plotë, në periudhën e likuidimit përfundimtar të punëve tona. I kishim hequr me kohë tabelat që vareshin para hyrjes së dyqanit tonë. Nën qepenat e lëshuara përgjysmë nëna po shiste tinës mallin e mbetur. Adela qe larguar në Amerikë. Tregonin, se anija me të cilën lundronte ajo, ishte mbytur, dhe të gjithë pasagjerët vdiqën. Ne asnjëherë nuk u besuam këtyre zërave; gjurmët e vajzës humbën, ne nuk dëgjuam më për të. Kishte ardhur një epokë e re, e zbrazët, e esëllt dhe e pagaz – e bardhë si një letër. Shërbëtorja e tanishme, Genja, një anemike e zbehtë dhe e pakockë, bridhte butësisht nëpër dhoma. Mjaftonte t’i ledhatoje shpinën, që ajo të shtriqej, të spërdridhej, si një gjarpër, dhe mjaullinte, si një mace. Ajo kishte një lëkurë me bardhësi të turbullt, që nuk purpurohej madje as në të prapmen e qepallave të syve të saj të emaluar. Kur përhumbej, ndodhte që, nganjëherë, ajo të gatuantë një qull të nxehtë prej faturash të vjetra dhe blloqesh kuatizacioni, – diç të neveritshme e të pagëlltishme.

Gjatë kësaj kohe im atë tashmë kishte vdekur krejtësisht. Ai pati vdekur disa herë, por jo plotësisht, gjithnjë me një farë

rezerve, duke na shtrënguar ta rishikojmë vetë aktin e kësaj ngjarjeje, gjë që kishte dhe anën e vet pozitive. Duke e përjetuar vdekjen e tij, mund të themi, me këste, babai si të thuash, na pati përgatitur me faktin e ikjes së tij nga kjo botë. Ne u bëmë shpërfillës ndaj rikthimeve të tij të përsëritura, me formatin e trupit gjithë e më të reduktuar, gjithë e më të mjerë. Tashmë fytyra e të papranishmit, m’u sikur shkapërderdhej nëpër dhomën, në të cilën banonte im atë, shkapërdahej, duke krijuar në disa pika droçka të çuditshme gjaku të një n g j a s h m ë r i e pabesueshmërisht shprehëse. Vende-vende letra e mureve imitonte konvulset e tikut të tim eti, arabeskat përfitonin formën e anatomisë së brengosur të qeshjes së tij, të zbërthyer në gjymtyrë simetrike, m’u si një mbresë e gurëzuar triboliti[1]. Për njëfarë kohe ne i rrinim larg, në shmang, gëzofit të tij me lëkurë qelbësi. Gëzofi i tij frymëmerrte. Paniku i kafshëzave, të qepura e të kacavjerrura në njëra-tjetrën, merrte arratinë me një drithërimë të pafuqishme nëpër të dhe shuhej e humbiste nëpër palat e kadifenjta. Me të ngjeshur veshin, mund të dëgjoje shpirrëzat e frymëmarrjes së

tyre në akord me gjumin. Në një formë të tillë, të rrahur fort, ndjehej një erëzim i lehtë qelbësash, vrasjeje dhe menstrualesh natësore.

Njëherë nëna ktheu nga qyteti me një fytyrë të merakosur. – Shiko, Josif, — tha ajo, — çfarë vakie. Arrita ta kap në shkallë; ai kërcente pupthi nga shkallarja në shkallare. — Dhe zbuloi paksa shaminë mbi diçka, që gjendej në pjatë. Unë njoha saora aty tim atë. Ngjashmëria ishte e padyshimtë, dhe pse këtë çast ai ishte ose gaforre, ose ndonjë akrep i madh. Ne ia pohuam këtë njëri-tjetrit me vështrime, të tronditur thellë prej asaj ngjashmërie, e cila përgjatë gjithë ndryshimeve dhe metamorfozave të binte haptazi në sy.

– A është i gjallë? – pyeta unë. – Ta pret mendja, unë mezi po e mbaj,- tha nëna, – ndoshta do të ishte më mirë ta lëshoja në dysheme?

Ajo e vendosi pjatën në dysheme, dhe ne, duke u përkulur mbi të, nisëm ta kundronim me vëmendje të përqendruar. I ndrysur ndërmjet këmbëve të tij të shumta e shtrembaluqe, ai mezi lëvizte me to. Me mashat dhe mustaqet paksa të ngritura ai duket se vigjëlonte. Unë anova pjatën, dhe im atë pas një grime ngurrimi u zhvendos në dysheme, por, me t’u

gjendur në sipërfaqen e rrafshët, befaz vrapoi me të gjitha këmbët e tij të shumta, duke trokitur me gjymtyrët e ashpra kockore. Unë ia gardhova rrugën. Me të prekur me mustaqet levarashe barrierën, ai u mëdysh, e mandej ngriti mashat dhe u kthye mënjanë. E lejuam të ngarendte në atë drejtim që i caktuam ne. Mobilje ku mund të gjente strehë, nuk kishte përpara. Duke nxituar dhe duke u drithëruar valë-valë mbi këmbët e tij të shumëfishta, ai mbërriti murin dhe kur ne s’e kishim bërë ende as një rrahje qerpiku, ai, pa vonesë, vrapoi murit përpjetë me gjithë armaturën e gjymtyrëve të tij. U shkunda prej një neverie instinktive duke këqyrur atë lëvizje vraparake shumëgjymtyrëshe, me goditjet që bënte mbi letrën e murit. Ndërkaq babai mbërriti në bufenë e vogël, të murosur në thellomën e murit të kuzhinës, studioi me masha brendësinë e tij, u çapit përmes zgripit, mandej humbi brenda i gjithi.

Nga perspektiva e tij e re prej gaforreje, ai po prezantohet sërish, në njëfarë mënyre, me apartamentin, duke i njohur objektet, me gjasë, me nuhatje, ngase, sado imtësisht që e pata kundruar, nuk arrita të zbuloj tek ai asnjë organ shikimi. Me sa duket, ai ndjente vështirësi

me sendet që ndeshte rrugës, ndalonte ndanë tyre, duke i prekur mezidukshëm me mustaqet e tij levarashe, madje i përqafonte këto sende me masha, m’u si të ishte duke i provuar apo mbase duke u prezantuar, mirëpo me të kaluar pak kohë i braktiste aty dhe vraponte më tutje, duke tërhequr osh barkun e ngritur paksa mbi dysheme. Po kështu vepronte ai me trohat e mishit dhe bukës, të cilat, duke pandehur se do t’i hante, ne ia hidhnim në dysheme. Por ai vetëmse i prekte nxitimthi dhe mërtisëj tej, pa gjykuar se në to mund të gjente diç të ngrënshe.

Gjatë vëzhgimit të hulumtimeve të tij durimtare nëpër dhoma mund të fitoje përshtypjen, se ai diç po kërkonte imtësisht e pandërprerje. Kohë pas kohe ai vraponte në një qoshk të kuzhinës poshtë një voze që rridhte e mbushur bēzēpērbuzē dhe, duke sosur ndanë një pellgaceje, dukej sikur pinte. Me gjasë, ai ia kalonte për bukurë pa ushqim, dhe nuk se binte në sy, por ky ishte dhe shkaku, që fuqitë e tij jetësore po dobësoheshin. Me një ndjenjë të përzim turpi dhe neverie ne ruheshim fshehtas, mos natën ai mendonte të na vizitonte në shtrojet e fjetjes. Por kjo nuk ngjau asnjëherë, megjithëse gjatë ditës ai

zvarritej mbi të gjitha mobilitet dhe pëlqente veçanërisht të fshihej në plasat ndërmjet dollapëve dhe murit.

Dis shenja të arsyes dhe madje të një farë vullneti lojacak nuk mund të mos i vëreje. Për shembull, çdo herë, gjatë kohës së ngrënies, babai shfaqej në tryezë, ani pse pjesëmarrja e tij në drekë mbetej vetëmse platonike. Nëse dera e dhomës së ngrënies mund të bënte vaki të ishte rastësisht e mbyllur, ndërsa babai gjendej në dhomën fqinje, ai, duke rendur para-prapa përgjatë të çarës poshtë derës, gërvishhte aq këmbëngulshëm, derisa dikush t'ia hapte. Më vonë ai u mësua të ushtrojë forcë, duke ngjeshur mashat dhe këmbët në plasën e nënderës dhe pas një-dy të shtyrash intensive brinjazi, trupi i tij hynte brenda, për nën derë. Kjo, me sa dukej, i jepte atij kënaqësi, qëndronte i nemitur nën tavolinë, shtrihej i qetë me barkun që mezi i pulsonte. Se çfarë domethënie kishte ky puls i ritmik i barkut të tij shkëndritës, ne s'arrim t'ia qëllonim dot. Këtu me gjasë fshihej ndonjë nëntekst ironik, dashakeq e i pahijshëm, që, me sa dukej, shprehte njëfarë poshtërsie hakmarrëse dhe njëfarë ndjenje kënaqësie. Qeni ynë, Nimbrodi, i avitej ngadalë e i pasigurtë, e nuhaste me kujdes, teshtinte dhe largohej shpërfillës, pa krijuar përfundimisht një mendim të tijin për të.

Rrënimi në shtëpi vazhdonte dhe zgjerohej. Genja s'bente gjë tjetër veç flinte gjithë ditën e lume; trupi i saj proporcional ulëj e ngrihej prej çdo frymimi të thellë. Ne shpesh gjenim në supë cefka peri, që ajo, e turbulluar e tytkë siç ishte, i hidhte në tenxhere bashkë me zarzavatet. Dyqani ishte i hapur in continuo ditë e natë. Shitja me qepanat e lëshuar përgjysmë vazhdonte çdo ditë mes ndërdyshjes për t'i ngritur apo ulur çmimet. Si të mos mjaftonin këto të gjitha ia behu edhe xhaxha Karoli.

Ai ishte i një mizantrop i pafjalë dhe më duket, me një dërrasë mangut. Me fshamje pezmatuese shpall, se për shkak të disa tersllëqeve që i kishin bërë vaki kohët e fundit, ka vendosur të ndryshojë mënyrën e jetesës dhe të kapet pas mësimi të gjuhëve të huaja. Nuk dilte nga shtëpia, mbyllej në dhomën më të largët, prej së cilës Genja, e mbushur plot antipati ndaj mysafirit të ri, i kishte ngritur të gjitha tapetet dhe qylimat muralë dhe kridhej në studimin e listave të vjetra të çmimeve të mallrave. Disa herë xhaxha Karoli u përpoq qëllimshëm ta shkelte tim atë në bark. Me klithma tmerruese ne iu kundërvumë këtij rreziku. Po ai, duke mbetur në

të tijën, vetëm se ngërdheshej me ligësi, ndërkaq që im atë, pa ia patur idenë përmasës së rrezikut që i kanosej, ndalonte i nemitur mbi ndofarë njollash në dyshemë.

Im atë – i cili në këmbë të veta ishte i shpejtë e i lëvizshëm – sikundër çdo gjallesë në trajtë gaforreje, mbetej krejtësisht i pambrojtur, sa herë rrokullisej dhe mbetej me shpinë në dyshemë. Ishte një pamje tejet e pikëllueshme, kur dëshpërueshëm përpiquej me të gjitha këmbët, por s'bente tjetër, veçse vërtitej i pashpresë në shpinë rreth aksit të vet. Ishte e pamundur ta kundroje pa keqardhjeje mekanikën qartësisht të spikatur dhe pothuaj, të paturpshme, të anatomisë së tij, që shpalosej ashtu cullake në sipërfaqe me barkun e segmentuar, pa asnjë mbulesë. Në të tilla raste xhaxha Karoli shestonte ta shtypte në kuptimin e saktë të kësaj fjale. Ne nxitonim t'i vinim në ndihmë, i zgjasnim tim eti ndonjë send, pas të cilit ai kapej gjithë drithërima me mashat e tij dhe, përfuthte saora gjendjen e tij normale, mandej pa vonesë dhe me një shpejtësi të dyfishuar turrej vetëtimë me zigzake rrethore, m'u si të donte ta fshinte kujtimin e kauzës së kompromentuar.

Me një ndjenjë ligështie unë jam i detyruar ta shtrëngoij veten dhe të parashtroj, për hir të së vërtetës, një rrethanë, realiteti i së cilës bën të rrënqethet tërë natyra ime. Deri më sot ende nuk arrij ta rrok, se si ne të gjithë u gjendëm fajtorë të vetëdijshëm të asaj ngjarjeje. Nga ky këndvështrim ajo ngjarje përfiton karakterin e njëfarë fatliteti të çuditshëm. Sepse fataliteti nuk e injoron ndërgjegjen dhe vullnetin tonë, por i përfshin ato në mekanizmin e vet në atë mënyrë, që ne, mu si në një gjumë letargjik, lejojmë dhe pranojmë pikërisht atë, prej së cilës ngjethemi në kushtet normale.

Kur i tronditur prej asaj që ngjau, unë e pyeta i dëshpëruar nënën:

– Si munde, si pate zemër ta bësh këtë! Nëse do të kishte qenë, fjala vjen, Genja, atëherë tjetër punë, por ti...?!

Nëna qau, spërdrodhi duart, por asgjë të qartë nuk arriti të thoshte. Ka menduar vallë ajo, që për babain kjo do të ishte më mirë; e shihte vallë ajo atë ngjarje si të vetmen zgjidhje nga situata pa shtedaldeje, apo kishte vepruar thjesht, me një mendjelehtësi të pakuptueshme, pa e vrarë mendjen?... Fatumi gjen njëmijë kurthe, nëse çështja prek forcimin e vullnetit të pakuptimtë. Njëfarë ërrësimi i cekët e i menjëhershëm, një grimëçast verbimi apo

pakujdesie është i mjaftueshëm, që ta tërheqë aktin për ta shpënë ndërmjet Shillës dhe Haribdës së zgjidhjeve tona. Mandej mundesh pa të sosur ex post të interpretosh dhe të gjykosh motivet, të vihesh në kërkim të shkaqeve nxitëse – por ajmë, fakti që është kryer bëhet i pakthyeshëm dhe mbetet njëherë e përgjithmonë i kryer. Ne e morëm veten dhe dolëm nga terratisja jonë, vetëm atëherë, kur tim atë na e sollën të shërbyer në gjellë. Qëndronte shtrirë, i madh dhe i zbrujtur nga zierja, i zbetë e i hirtë, i derdhur në xhelatinë. Ne qëndronim si mbi gjemba. Vetëm xhaxha Karoli zgjati pirunin, por në gjysmë të rrugës, i pasigurt, e tërhoqi prapë, duke na parë me habi. Nëna urdhëroi ta shpinin pjatën në dhomën e pritjes. Atje, mbi tavolinë, mbuluar me një sofrabevë pikëlor, ndanë një albumi me fotografi dhe një kutizë muzikore, qëndronte para nesh pjata me atin tim të gatuar.

Megjithatë nuk qe e thënë të përmbylleshin me kaq udhëtimet rraskapitëse tokësore të tim eti, dhe vazhdimi, vazhdimi i historisë së tij, përtej, siç më duket mua, përtej kufijve

të imagjinuar, përbën dhe pikën më të dhembshme të tij. Përse pra ai, tekefundit, nuk u dorëzua, përse nuk e pranoi disfatën e tij, kur në të vërtetë i kishte të gjitha arsyet dhe fati nuk kishte pse të shkonte aq larg, duke e torturuar dhe sflitur aq egër? Pas disa javësh në gjendje të palëvizshme ai, si të thuash, e mblodhi vetën, erdhi, si të thuash, në vete. Një mëngjes ne zbuluam, se pjata ishte bosh. Vetëm njëra këmbë gjendej në buzë të pjatës, mbetur e ngrirë në salcën e ftohtë të domates, gjatë sforcimit për t'u arratisur. I zier, me këmbë të humbur, ai me forcat e fundit bëri më tej, në bredhëritjen e pastrehë, dhe ne kurrë më nuk e pamë.


Shënim për autorin:

Bruno Shulc (1892 – 1942) lindi në qytetin Drogobiç (asokohe – Austro-Hungaria, pastaj – Polonia, BRSS, tash – Ukraina e pavarur), ku jetoi gjer ditën e vdekjes, praktikisht pa u larguar gjatë. Njihet i famshëm si piktor ekspresionist. Gjithsej botoi dy vëllime me tregime “Dyqanet e kanelës” (1934) dhe “Sanatoriumi ndanë Klepsidrës” (1937). Me librin e dytë fiton çmimin

“Dafina e artë”, dhënë nga Akademia e Letërsisë Polake, president i së cilës ka qenë poeti i madh polak Boleslav Lesmjan. Më 1936 botohet me përkthimin e tij romani “Procesi” i Franz Kafkës. La të pambaruar romanin “Mesia”. Më 19 nëntor 1942, ditën e spastrimit masiv mbi hebrenjtë nga gestapoja naziste e milicisë ukrainase, vritet edhe Bruno Shulci, siç dëshmojnë të dhënat mbi të, nga dora e një prej adhuruesve të tij. Konsiderohet i zhdukur gjithë arkivi i tij letrar dhe epistolar; mbeti vetëm ajo çka pati publikuar shkrimtari. Këtë fat patën dhe pikurat e tij. Ndikimi i tij ka qenë i jashtëzakonshëm ndër brezat e shkrimtarëve evropianë të pasluftës. Rizbulimi i Shulcit ka marrë një hov të madh pas viteve '90. Danillo Kish, sikundër dëshmon në memuarët e tij Xh. Apdajk, thosh se: “Në lëtrësi unë kam veçse një hy, dhe ky është Bruno Shulci”.

[1] (Lat. Trilobita) — klasë e vdekur detare shumëkëmbëshash, që ka patur një rëndësi të madhe për faunën e formacioneve paleozoike . (Shën. Përkth).

*Exlibris.al /
Përktheu: Agron TUFA*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani dimëron në pozitën e parë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Është mbyllur stinori vjeshtor në BKT Superligën e Kosovës në futboll. Gjilani do të dimërojë në pozitën e parë në renditje, duke iu falënderuar fitores si mysafir ndaj liderit të parë të kësaj jave, Ballkanit, me rezultat 1:0. Deri tek arkëtimi i tri pikëve tejet të rëndësishme gjilanasit erdhën në sajë të supergolit të Gerhard Prognit në minutën e 75-të, me gjuajtje të fortë nga rreth 20 metra. Ky ishte goli i 12-të i Prognit në këtë edicion, teksa Gjilani e mbyll stinorin vjeshtor me 35 pikë, me një pikë më shumë se rivalja lokale, Drita, përkatësisht 2 më shumë se Ballkani, që tashmë renditet i treti. "I falënderoj djemtë pasi kemi pasur ndeshje të fortë, kundërshtar të mirë që di të luaj futboll. Janë të gjithë lojtarë të mirë dhe kundërshtarë në disa çaste më i mirë se ne, por ne e kemi shfrytëzuar përvojën e lojtarëve tanë, cinizmin. E kemi njohur kundërshtarin shumë mirë. Cale dhe Torrassa kanë qenë vendimtarë te goli i Prognit, që ka qenë spektakolar. Me të vërtetë e kanë kuptuar edhe lojtarët

strategjinë dhe i përshtatemi çdo kundërshtari për të arritur rezultat pozitiv. Jemi për titull kampion, jemi skuadër shumë e fortë dhe kemi bërë ndeshje shumë të mira", ka thënë trajneri i Gjilanit, Ismet Munishi. Ndeshja tjetër e zhvilluar në stadiumin "Liman Gegaj" ndërmjet Malishevës dhe Dukagjinit u mbyll pa fitues, me rezultat 2:2. Mysafirët shkuan në pushim me epërsinë e një goli, pas shënimit të Ergyn Ahmetit, në minutën e 44-t. Megjithatë, në pjesën e dytë Malisheva arriti ta përmbysë përkohësisht rezultatin me golat e Agron Bruqit (58') dhe Dren Kryeziut (62'), teksa baraspeshën në rezultat e riktheu Bujar Shabani, me golin e realizuar në minutën e 65-të. Të shtunën janë zhvilluar tri ndeshje në kuadër të javës së 18-të në Superligë. Llapi ka shënuar fitore në përballje me Prishtinën, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, me rezultat 3:2. Deri tek arkëtimi i tri pikëve të rëndësishme llapanët erdhën pas një loje tejet interesante dhe dramatike deri në fund. Llapi kaloi në epërsi pas



autogolit të Benet Ismailit në minutën e 24-t, ndërsa dy golat e tjerë për vendësit i shënuan Francisco Rivera në minutën e 27 dhe Kushtrim Shabani në minutën e 97. Ndërkaq golat për Prishtinën i shënuan Arlind Shabani nëpërmjet Arlind Shabanit në minutën e 43-të dhe Sabien Lilajt në minutën e 61-të. Me këtë fitore, Llapi shkon në pushimin dimëror me 29 pikë në vendin e katërt, kurse Prishtina mbetet në pozitën e pestë me 24 pikë. Fitore si vendase ka shënuar

edhe Drita në duel me Ulpianën me rezultat 3:1. Megjithatë, deri te kjo fitore skuadra gjilanasë erdhi me mjaft vështirësi në fushën e rënduar për shkak të reshjeve të shiut. Të parët në epërsi kaluan vendasit me golin e Arbnor Mujës në minutën e 39-të, por pas shtatë minutash lojë në pjesën e dytë mysafirët rikthyen baraspeshën në rezultat me golin e Egzon Qerimit. Mirëpo, angazhimi dhe këmbëngulja e madhe e vendasve për fitore rezultoi e suksesshme në minutat shtesë të ndeshjes, kur

BKT SUPERLIGA

Ballkani - Gjilani	0-1
Malisheva - Dukagjini	2-2
Drita - Ulpiana	3-1
Feronikeli - Drenica	0-2
Llapi - Prishtina	3-2

Tabela

	Pikë
1. Gjilani	35
2. Drita	34
3. Ballkani	33
4. Llapi	29
5. Prishtina	24
6. Drenica	23
7. Malisheva	19
8. Dukagjini	18
9. Ulpiana	18
10. Feronikeli	11

fillimisht Astrit Fazliu realizoi në minutën e 92-të dhe më pas Marko Simonovski vendosi rezultatin përfundimtar në minutën e 100. Drita tani ka 34 pikë, kurse Ulpiana mbetet në pozitën e tetë me 18 pikë. Ndërkohë, Drenica ka shënuar fitore si mysafire në Drenas, në duel me Feronikelin, me rezultat 2:0, me golat e shënuara nga Kreshnik Uka në minutën e 21-të dhe Fatlum Gashi në minutën e 51-të. Stinori pranveror në BKT Superligë do të nisë më 12 shkurt.

Kampioni vazhdon të fitojë, Rahoveci shkatërroi Kamza Basketin

TIRANË, 12 DHJETOR - Golden Eagle Ylli ka vazhduar me fitore, duke mundur në udhëtim Tirana Neptun me rezultat 71:103 (23:23, 19:29, 12:22, 17:29), në kuadër të javës së gjashtë të Ligës Unike. Çereku i parë i ndeshjes ishte i barabartë dhe u karakterizua me shumë barazime dhe herë njëra skuadër kalonte në epërsi dhe herë tjera, ndërsa përfundoi me shifrat 23:23. Pesë minutat e periudhës së dytë ishin të barabarta, deri te rezultati 36:36, e më pas therandasit ishin më të mirë, duke shkuar në pushim me rezultat 42:52. Kampionët vazhduan me lojë të mirë dhe thelluan epërsinë deri në 22 pikë, 48:70, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 54:74. Kampionët e Kosovës dhe



Ligës Unike nuk u ndalën as në dhjetë minutat e fundit për ta thelluar edhe më shumë epërsinë

dhe triumfuan 71:103. Te Tirana Neptun u dallua Reggie Clark me 26 pikë e pesë kërcime, kurse te

Golden Eagle Ylli u dalluan Henrik Sirko me 23 pikë e gjashtë asistime, Gëzim Morina, me 14 pikë, shtatë kërcime dhe tetë asistime, si dhe Erjon Kastrati, me 22 pikë e gjashtë kërcime. Tirana Neptun ka tri fitore dhe tri humbje, kurse Golden Eagle Ylli gjashtë fitore dhe një humbje. Rahoveci ka shënuar fitore të thellë ndaj Kamza Basket me rezultat 98:56 (31:10, 25:8, 25:18, 17:20), në kuadër të javës së gjashtë në Ligën Unike. Vendasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke dominuar në çdo aspekt ndaj mysafirëve dhe qysh në çerekun e parë krijuan epërsi deri në 22 pikë, 29:7, ndërsa kjo pjesë mbyllet me shifrat 31:10. Ata vazhduan me ritëm të lartë edhe në periudhën e dytë, duke mos u ndalur, dhe shtuan epërsinë,

që arriti deri në 40 pikë, 56:16, kurse pjesa e parë përfundoi me rezultat 56:18. Perioda e tretë ishte më e barabartë por, sidoqoftë, ishte nën kontrollin e Vreshtarëve, që shtuan edhe më tutje epërsinë, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 81:36. Dhjetë minutat ishin formale me fituesin që tashmë dihej dhe Rahoveci triumfoi me shifrat 98:56. Te Rahoveci u dalluan Milik Yarbrough me 15 pikë, shtatë kërcime dhe gjashtë asistime, Cavon Baker me 19 pikë e shtatë kërcime dhe Tyheim Monroe me 17 pikë e 12 kërcime, kurse te Kamza Basket u dallua me 17 pikë e nëntë kërcime. Tashmë të dyja skuadrat kanë nga dy fitore dhe katër humbje.

New York City shkruan historinë, shpallet kampion në MLS

NJU-JORK, 12 DHJETOR - New York City ka shkruar historinë në futbollin amerikan, pasi për herë të parë ka fituar kampionatin amerikan. Skuadra nga New Yourku është shpallur kampion e MLS-së e cila ka debutuar në elitën më të lartë të futbollit

në Amerikë në vitin 2015. Për t'u shpallur kampion e MLS-së, skuadrës së New York City i është dashur ta mposhtë Portland Timbersin dhe kjo është arritur vetëm falë gjuajtjeve të penalltisë, ku "ruleta ruse" i buzëqeshi skuadrës nga New Yorku.

Koha e rregullt e sfidës përfundoi 1-1. Skuadra e teknikut Ronny Deila kaloi e para në avantazh falë golit të shënuar nga Castellanos, por kundërshtarët barazuan në minutat e fundit të kohës shtesë. York City arriti të triumfojë pas gjuajtjes së

penalltive falë pritjeve të portierit Johnson. Skuadra feston titullin e parë në histori, po ashtu edhe tekniku norvegjez Ronny Deila që, pas sukseseve në Norvegji me Stromsgodset



dhe Skoci me Celtic, fiton titullin e parë në Amerikë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022, nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 26.2, 27.3, 39 dhe 42 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm Nr. 2538 të datës 10.12.2021 për plotësimin e vendeve të lira të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

- 1. Pozita:** Auditor për auditim financiar dhe pajtueshmërisë;
Numri i referencës: AAFP/ZKA/01-01/22
Grada: ZKA-A7
Numri i pozitave: Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë bazuar në planin vjetor dhe në Manualin e ZKA-së, i cili është i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe i raporton UE dhe UD (nëse kërkohet);
- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e planifikimit, të dosjeve të auditimit, në shkrimin e memove të komponentëve, draft raporteve të Auditimit, dhe komenteve eventuale që ndërlidhen me to dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shfrytëzon gjykimet profesionale dhe teknikat e sakta analitike për të arritur deri të konkluzionet e qëndrueshme në bazë të dëshmi të mbledhura gjatë procesit të auditimit;
- Shkrimi i rrjedhshëm i Letrave të punës së auditimit duke i strukturuar gjetjet sipas të gjitha elementeve, si dhe të nxjerr konkluzione këshilla/rekomandime të qarta për çështjet e trajtuara që mund t'i ndihmojnë entitetit të audituar;
- Kompletimi dhe Indeksimi i Letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia dhe me kohë i dorëzon të UE, për t'i arritur planet e aprovuar nga Menaxhmenti;
- Ndihmon ekipin dhe departamentin rreth përdorimit të teknikave audituese, teknologjisë informative, po ashtu ndihmon UE dhe UD për punë dhe detyra tjera sipas kërkesave dhe udhëzimeve të tyre;
- Ofron bashkëpunim dhe komunikim të mirë me anëtarët e ekipit, me departamentin, dhe me sektorët e tjerë në kuadër të ZKA-së si: administrata, financat, burimet njerëzore dhe transporti, gjithmonë në kohë dhe mënyrë racionale;
- Të ruajë dhe azhurnojë njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregojnë gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat të dakorduara me UE gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ZKA, dhe tregojnë integritet të lartë dhe vepron në pajtim me kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së; dhe
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale që mund të kërkohen nga UE dhe UD të tij/saj.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist i certifikuar ose auditor i sektorit publik);
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike, prej tyre, së paku tre (3) vite në auditim të jashtëm.

- 2. Pozita:** Auditor junior për auditim të performancës;
Numri i referencës: AJAP/ZKA/02-01/22
Grada: ZKA-A8
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;(nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzive dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimet profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës. fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvojë në auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Pozita: Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë angleze dhe anasjelltas;

- Numri i referencës:** PSA/ZKA/03-01/22
Grada: ZKA-C6
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Benë përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bënë përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe në përputhje me normat gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve;

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.

4. Pozita: Zyrtar për përkrahje të sistemeve;

- Numri i referencës:** ZPS/ZKA/04-01/22
Grada: ZKA-C4
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon në menaxhimin i sistemit elektronik të menaxhimit të auditimit dhe sistemeve tjera në ZKA;
- Ofron mbështetje për personelin e ZKA-së, nga fusha e sistemeve softuerike.
- Ndihmon në menaxhimin e roleve të përdoruesve të sistemeve të brendshme;
- Mbështet Specialistin për teknologji të informacionit në menaxhimin e bazës së të dhënave të sistemeve të brendshme të ZKA-së.
- Përpilon raporte ad-hoc nga baza e të dhënave dhe azhurnon shabllonet e dokumenteve sipas kërkesave.
- Shërben si help-desk për çdo kërkesë apo ndihmë që paraqitet nga personeli i ZKA-së në lidhje me sistemet e brendshme.
- Menaxhon me detyra administrative që lidhen me mbështetjen e sistemeve në ZKA.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informacionit.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data XX.12.2021, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data xx.12.2021, ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Plana za zapošljavanje radnika za 2022. godinu, članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 26.2, 27.3, 39 i 42 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 2538 datuma 10.12.2021 za popunjavanje slobodnih radnih mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Položaj: Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti;
Broj reference: AAFP/NKR/01-01/22
Nivo: ZKA-A7
Broj radnih mesta: Dva (2)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Vrši finansijske revizije i revizije usklađenosti na osnovu godišnjeg plana i Priručnika NKR-a, koji je zasnovan na Međunarodnim standardima revizije i izveštava VT i VD (ako se zahteva);
- Pomaže VT u prikupljanju preliminarnih informacija o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi planiranja, revizijskih dosijea, pisanju memoranduma o komponentama, nacrtu izveštaja o reviziji i svih eventualnih komentara i drugih poslova u vezi sa revizijom;
- Koristi profesionalne prosudbe i tačne analitičke tehnike da bi došao do doslednih zaključaka na osnovu dokaza prikupljenih tokom procesa revizije;
- Tečno pisanje revizorskih radnih papira strukturirajući nalaze prema svim elementima, kao i davanje jasnih saveta/preporuka o adresiranim pitanjima koja mogu pomoći subjektu revizije;
- Kompletiranje i indeksiranje radnih papira za revidirane teme (uzorke) i oblasti i svi dokumenti (uključujući i one primljene u Entitetima) moraju biti u skladu sa formatom i zahtevima utvrđenim metodologijom i blagovremeno dostavlja kod VT, kako bi postigao odobrene planove od strane Menadžmenta;
- Pomaže timu i odeljenju u korišćenju revizorskih tehnika, informacione tehnologije, takođe pomaže VT i VD za druge zadatke i zadatke prema njihovim zahtevima i uputstvima;
- Pružiti dobru saradnju i komunikaciju sa članovima tima, odeljenjem i drugim sektorima u okviru NKR kao što su: administracija, finansije, ljudski resursi i transport, uvek blagovremeno i racionalno;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT tokom procene učinka za prethodnu godinu, i da pohađa obuke koje organizuje NKR koje se povezuju sa Kontinuiranim Profesionalnom Obrazovanjem;
- Da bude odgovoran u vršenju dužnosti za realizaciju ciljeva NKR-a, i pokazuje visok integritet i ponaša se u skladu sa Kodeksom etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i izvan NKR-a; i
- Obavlja i druge stručne zadatke koje može zahtevati od njegovog/njenog VT i VD.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Sertifikat za spoljnu reviziju (ovlašćeni računovođa ili revizor javnog sektora);
- Pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi, od čega najmanje tri (3) godine u spoljnoj reviziji.

2. Položaj: Revizor Junior za reviziju učinka;

Broj reference: AJAP/NKR/02-01/22
Nivo: ZKA-A8
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR-a, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava direktoru Departmana revizije i šefa revizorskog tima;
- Vrši istraživanja i analize za određenu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR (pod nadzorom VR);
- Aktivno učešće u pred-studijama revizije u određenim oblastima delegiranih od VT;
- Pružiti stručnu podršku sprovođenju istraživanja i analize prikupljenih podataka i njihovom prezentacijom;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjua i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Pravovremena priprema radnih papira zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponenti, oblasti ili pitanja revizije koja mu je dodeljena;
- Indeksiranje radnih papira i diskusija sa njegovim/njenim vođom;
- Kontinuirano izveštavanje kod nadzornika o napretku postignutom u reviziji;
- Primena rada online prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge stručne poslove koje zahteva VTR i direktor Departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju ili analize, poželjno iskustvo u reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

3. Položaj: Prevodilac - sa albanskog na engleski i obrnuto;

Broj reference: PSA/NKR/03-01/22
Nivo: ZKA-C6
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vodi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vrši prevod dokumenata sa albanskog na engleski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevođenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vrši simultano prevođenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata;

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva od kojih jedna (1) godina dokaz u oblasti prevođenja.

4. Položaj: Službenik za podršku sistema;

Broj reference: ZPS/NKR/04-01/22
Nivo: ZKA-C4
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u upravljanju elektronskim sistemom upravljanja revizijom i drugim sistemima u NKR;
- Pružiti podršku osoblju NKR, u oblasti softverskih sistema.
- Pomaže u upravljanju ulogama korisnika internih sistema;
- Podržava specijalistu za informacione tehnologije u upravljanju bazom podataka internih sistema NKR-a.
- Sastavlja ad-hoc izveštaje iz baze podataka i ažurira šablone dokumenata po zahtevu.
- Služi kao help-desk za sve zahteve ili pomoć koje podnese osoblje NKR-a u vezi sa internim sistemima.
- Upravlja administrativnim poslovima vezanim za podršku sistema u NKR.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu nadzornika.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz oblasti informacionih tehnologija.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 13.12.2021 .godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 28.12.2021.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues